

ra e fundit kur atë e shihnin të gjallë. Në mbrëmje, kur pushuan krismat, banorët e fshatit e kanë gjetur trupin e pajetë të Kadriut përpara shtëpisë së Osman Çollakut. E kishin qëlluar me dy plumba në kokë. E bartën trupin e tij në shtëpi, por nuk kanë mundur ta varrosnin për shkak të pranisë së forcave serbe përreth. Kur djali i Kadriut u kthye në fshat më 7.11.1998, e ka gjetur shtëpinë e rrënuar dhe të shkrumbuar dhe trupin e karbonizuar të të atit. Të nesërmen, ai i ka varrosur mbetjet mortore të Kadriut në një livadh pranë shtëpisë. Pas përfundimit të luftës, më 25.06.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata E.P, FDH-15407; deklarata E.D, FDH-18986; *Multilated Bodies of Albanians Found in Skenderaj and Istog*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.11.1998, FDH-30645.

Din (Salih) Loshi

(1902, shqiptar nga Padalishta/Padalište, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë)

Dini jetonte vetëm në shtëpinë e vet në *Mëhallën Loshi* në Padalishtë/Padalište. Djali i tij i vetëm jetonte në Gjermani, ndërkaq vajzat i kishte të martuara. Në datën **28.07.1998**, forcat serbe e bombarduan fshatin. Shumica e banorëve u zhvendosën nëpër pyjet, ndërkaq Dini i moshëthyer ndenji në shtëpi. Një ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën nga rajoni, i afërmi i tij Alushi u kthye në fshat dhe pranë kapisë së Dinit e ka gjetur trupin e tij të pajetë [Padalishtë/Padalište]. Me ndihmën e disa burrave, Alushi e ka varrosur Dinin në të njëjtën mbrëmje në varrezat e fshatit.

Burimi: deklarata A.L, FDH-18207.

Isuf (Muharrem) Sadiku

(4.05.1977, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Isufi aderoi në UÇK në fillim të vitit 1998. Në datën **28.07.1998**, ai me një grup ushtarësh qëndronin te pozicioni përmbi fshatin Padalishtë/Padalište. Atë ditë, forcat serbe e bombarduan fshatin. Në ato çaste, Isufi rastisi të ishte pranë

arës së Kamer Loshit. Një predhë eksplodoi shumë afër tij dhe e plagosi në kokë [Padalishtë/Padalište]. Pas pak, ai ndërroi jetë. Bashkëluftëtarët e kanë varrosur një ditë më vonë në arën e Kamer Loshit. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, trupi i Isufit u rivarros në varrezat e fshatit të tij të lindjes në Shushicë/Sušica.

Burimet: deklarata A.L, FDH-18206; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFUDUÇK, *Fenikset...*9, 135-136.

Halil (Adem) Abazi

(23.03.1978, shqiptar nga Klladërnica/Kladernica, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, i pamartuar)

Në datën 26.07.1998, familja e Halilit i ka strehuar në shtëpinë e vet në Klladërnice/Kladernica refugjatët nga Klina e Mesme/Srednja Kline. Në mesin e tyre ishin edhe halla e Halilit, Mihane, me fëmijë. Dy ditë më vonë [28.07.1998], Halili me djalin e Mihanes, Safetin, u nisën në Klinën e Mesme/Srednja Klina, për të marr disa gjësende. U nisën nga pasditja. Duke kaluar pranë **Skënderajt/Srbica**, te vendi i quajtur *Kodra e Kalit/Konjsko Brdo*, ata u vunë re nga pjesëtarët e forcave serbe të stacionuar në Fabrikën e Municionit, të cilët e hodhën një bombë mbi Halilin dhe Safetin. Që të dy u plagosën, por Halili i ka marr dëmtimet e rënda – në kokë dhe në gjoks. Familjarët e kanë bartur menjëherë Halilin në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac. Ka ndërruar jetë pas dy ditësh. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur në varrezat e Klladërnices/Kladernica.

Burimi: deklarata M.A, FDH-17337.

Dibran (Rexhep) Mecini

(11.05.1932, shqiptar nga Klina e Mesme/Srednja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, rojtar, gjashtë fëmijë)

Dibrani jetonte në bashkësi familjare me të birin Eminin dhe familjen e tij. Punonte si rojtar në fabrikën *Ardhmëria/Budučnost*. Nga droja prej sulmit të mundshëm të forcave serbe, bashkëshortja e Eminit me fëmijët e braktisën fshatin. Në shtëpi në **Klinën e**